



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada – Government*

*Ministria e Integritimit Evropian*  
*Ministarstvo za Evropske Integracije – Ministry of European Integration*

**FTESË PËR APLIKIM**

Ministria e Integritimit Evropian, në bazë të Nenit 5 të Rregullores Nr. 01/2016 për Subvencionimin e Projekteve dhe Aktiviteteve që Promovojnë Procesin e Integritimit Evropian të Republikës së Kosovës, fton personat fizik, grupet dhe organizatat jo qeveritare të interesuara, të aplikojnë për subvencionim të projekteve dhe aktiviteteve të tyre, të cilat kanë për qëllim promovimin e procesit të integritimit evropian të Republikës së Kosovës.

**Kushtet e përgjithshme për aplikuesit**

Personat fizik të cilët aplikojnë për subvencionim të projekteve dhe aktiviteteve të tyre duhet të përmbushin kushtet si në vijim:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të moshës mbi tetëmbëdhjetë (18) vjeç;
- Gjatë periudhës së pesë (5) viteve të fundit, të mos jenë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepër penale me dënim burgimi në kohëzgjatje prej më shumë se gjashtë (6) muaj; dhe
- Të mos jenë sanksionuar nga Ministria siç parashihet në Nenin 13 të Rregullores 01/2016.

Organizatave të cilat aplikojnë për subvencionim të projekteve dhe aktiviteteve të tyre duhet të përmbushin kushtet si në vijim:

- Të jenë të regjistruara në pajtim me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare;
- Gjatë periudhës së pesë (5) viteve të fundit, përfaqësuesi i organizatës të mos jetë dënuar me Aktgjykim të formës së prerë për vepër penale me dënim burgimi në kohëzgjatje prej më shumë se gjashtë (6) muaj; dhe
- Të mos jenë sanksionuar nga Ministria siç parashihet në Nenin 13 të Rregullores 01/2016.

**Kushtet specifike për aplikuesit**

Personat fizik dhe organizatat duhet të dorëzojnë projektet në përputhje me këto kritere:

- Aktivitetet për promovimin e MSA-së;
- Aktivitetet për mundësitë e eksportit dhe importit që parashihet MSA;
- Aktivitetet për informimin e qytetarëve për të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga procesi i liberalizimit të vizave;
- Aktivitetet për aspekte të veçanta të procesit të integritimit Evropian, dhe përafrimit të Kosovës me BE-në. Përparësi do t'u jepet projekteve që adresojnë çështjet e rinisë, sportit, kulturës, artit dhe grupeve të cënueshme të shoqërisë;
- Shuma maksimale për financim të një projekti është 3,000 EUR.

## Dokumentacioni i nevojshëm

Personat fizik të cilët aplikojnë për subvencionim të projekteve dhe aktiviteteve të tyre duhet të dorëzojnë në Ministri dokumentet në vijim:

- Fletë-aplikacionin e përcaktuar në Shtojcën 1 të Rregullores 01/2016;
- Projekt-propozimin së bashku me koston e llogaritur të projektit ose aktivitetit të prezantuar në mënyrë narrative dhe tabelore duke theksuar periudhën kohore brenda së cilës pritet të fillojë dhe të përfundojë projekti ose aktiviteti;
- Projekt-propozimi duhet të bazohet në formën e përcaktuar në Shtojcën 3 të Rregullores 01/2016;
- CV;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjen e kartelës bankare valide për llogarinë rrjedhëse; dhe
- Vërtetimin nga Gjykata lidhur me evidencën penale të aplikuesit.

Grupet prej dy ose më shumë personave të cilët aplikojnë për një projekt ose aktivitet të përbashkët, të cilët nuk janë të regjistruar si organizatë, duhet të caktojnë përfaqësuesin e tyre i cili me rastin e aplikimit në emër të grupit, duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e cekur si më lartë.

Organizatave të cilat aplikojnë për subvencionim të projekteve dhe aktiviteteve të tyre duhet të dorëzojnë në Ministri dokumentet në vijim:

- Fletë-aplikacionin e përcaktuar në Shtojcën 2 të Rregullores 01/2016;
- Projekt-propozimin së bashku me koston e llogaritur të projektit prezantuar në mënyrë narrative dhe tabelore duke theksuar periudhën kohore brenda së cilës pritet të fillojë dhe të përfundojë projekti;
- Projekt-propozimi duhet të bazohet në formën e përcaktuar në Shtojcën 4 të Rregullores 01/2016;
- Kopjen e letërnjoftimit të përfaqësuesit të organizatës;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të organizatës;
- Kopjen e certifikatës së numrit fiskal të organizatës;
- Kopjen e kartelës bankare valide për llogarinë rrjedhëse të organizatës; dhe
- Vërtetimin nga Gjykata lidhur me evidencën penale të përfaqësuesit të organizatës.

Aplikacionet e kompletuara duhet të dorëzohen në Arkivin e Ministrisë së Integritit Evropian, (ndërtesa e re e Qeverisë, rr. Nëna Terezë, p.n. Prishtinë) nga ora 08:00 - 16:00, duke filluar nga data 02.07.2016. Afati i fundit për aplikim është data 02.08.2016. Aplikacionet e kompletuara gjithashtu mund të dërgohen në formë elektronike në [subvencionet.mie@rks-gov.net](mailto:subvencionet.mie@rks-gov.net). Fletë-aplikacionet dhe të gjitha format e përcaktuara mund të shkarkohen nga webfaqja e Ministrisë së Integritit Evropian [www.mei-ks.net](http://www.mei-ks.net).